



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:166712

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05545082

C.nr.22/2017

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B (M) R nga Rahoveci, ndaj të paditurit Xh (J) Z nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, me vlerën e objektit të kontestit prej 3,100.00 euro, pas seancës së mbajtur më datën 04.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit B (M) R nga Rahoveci, ndaj të paditurit Xh (J) Z nga Rahoveci, në çështjen kontestimore C.nr.22/2017.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B (M) R nga Rahoveci, më datën 19.01.2017, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë kundër të paditurit Xh (J) Z nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, me vlerën e objektit të kontestit prej 3,100.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore për datën 31.01.2024, në të cilën seancë ka prezantuar i padituri, ndërsa në fletëkthesën e paditëses është konstatuar se i njëjti jeton jashtë vendit. Më datën 14.03.2024, kjo gjykatë me aktvendim të veçantë ka vendosur që dërgimi i ftesave, shkresave, aktvendimeve dhe komunikimi me paditësin B (M) R nga Rahoveci, tani me adresë të panjohur, tani e tutje do të bëhet me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate. Kështu, ftesën për seancën përgatitore të datës 04.04.2024 të caktuar në ora 09:30 e ka afishuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate më datën 14.03.2024.

Kështu, paditësja përkundër faktit se me anë të tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate është ftuar në mënyrë të rregullt, në seancën përgatitore nuk ka prezantuar dhe mungesën e tyre saj e ka arsyetuar.

Prandaj, gjykata ka vendosur ta konsiderojë të tërhequr padinë e paditësin për faktin se edhe pse e njëjta për seancën përgatitore të datës 04.04.2024 ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, i

njëjti në këtë seancë nuk ka prezantuar e mungesën e tij nuk e ka arsyetuar. Kështu, sipas nenit 409.1 të LPK-së parashihet që *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*. Sa i përket komunikimit të gjykatës me palën paditëse nëpërmjet tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate në nenin 116.5 të LPK-së parashihet që *“Në qoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 456.1 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 116.5 dhe 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.22/2017, më datën 04.04.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.